



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

MINISTRI

Nr.____.prot.

Tiranë, më____.____.2023

PROJEKT - UDHËZIM

**PËR KUSHTET TEKNIKE TË IMPORTIT-TREGETIMIT TË MIRMBAJTJES, TË TESTIMIT,
TË SHËRBIMIT TË APARATEVE TË FIKSEVE TË ZJARRIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 e nenit 8, të pikës 1,2,3,4, e nenit 44, të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim përcakton kriteret unifikuese dhe krijimin e një standarti, kriteret që duhet të kenë aparatet e fikseve të zjarrit dhe sistemet stacionare zjarrfikëse për garantimin e cilësisë, të rritjes së sigurisë, gatishmërisë për përdorim dhe kontrollin në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjithë personave fizikë dhe juridikë të cilët merren me importin, tregtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e fikesve të zjarrit dhe sistemet stacionare për shuarjen e zjarri, si dhe ndaj personave fizikë dhe juridikë të cilët duhet t’i posedojnë dhe shfrytëzojnë këto pajisje.

Neni 3

Përkufizime

1. **Fikse zjarri portative:** Pajisje që përmban agjent fikës / lende shuarese, i cili, nën veprimin e presionit të brendshëm, mund të nxirret dhe të drejtohet drejt zjarrit. Fikse portative e zjarrit është projektuar për t'u transportuar dhe përdorur me dorë, e cila në gjendje operationale ka peshe të lendes shuarese nga 1 kg - 12 kg.
2. **Fikse zjarri me rrota/karrel:** Është fikse zjarri me rrota/karrel, pesha e lendes shuarese kalon 12 kg.
3. **Fikse tavanore vetë-shuarës/automatik:** Fikse zjarri e cila vendoset në tavan dhe aktivizohet kur temperatura kalon një vlerë të paracaktuar duke shkarkuar automatikisht lëndë shuarëse në hapësirën ku është e montuar.
4. **Sistemet stacionare manuale dhe automatike për shuarjen e zjarreve:** janë një kompleks aparatësh dhe pajisjesh të ndryshme të cilat lidhen dhe konfigurohen me njera tjetren, që shërbejnë për shuarjen e zjarreve, me anë të ujit, të shkumës, të aerosolit, të gazit karbonik, të gazit të pastër ekologjik FM200 / NOVEC 1230 , mix gazrash etj.
5. **Trupi i fikses së zjarrit:** Përbëhet nga cilindri dhe aksesorët e fikës të zjarrit.
6. **Komponentët e fikses së zjarrit:** Janë pjesët e fikses së zjarrit të cilat në kushte normale funksionimi janë të lidhura në mënyrë të përhershme në cilindër dhe i nënshtrohen presionit.
7. **Kapaciteti i fikses së zjarrit:** Masa ose vëllimi i lendes shuarese që përmban fiksa e zjarrit. Kapaciteti i fikses me bazë uji/shkume shprehet në vëllim (litra), ndërsa e fikses të tjerë në masë (kilogram).
8. **Gazi shtytës:** Gazi brenda trupit të fikses së zjarrit ose në një bomboline që është i montuar ose i vendosur brenda ose jashtë fikses së zjarrit dhe përmes të cilit lëshohet lenda shuarëse.
9. **Lendet shuarese të zjarrit:** janë substanca në gjendje agregate të ndryshme, të cilat nepermjet fikses portative dhe me karrel/rrota apo sistemeve stacionare, leshohen/hidhen mbi lëndet e materialet që janë në proces djegie dhe realizojnë/bejnë shuarjen ftohjen e tyre, izolimin/vecimin e tyre nga oksigjeni i ajrit ose/dhe uljen e përqindjes së oksigjenit në ambientin ku zhvillohet zjarri, duke tentuar dhe/ose realizuar fikjen e zjarrit.
10. **Mirëmbajtja:** Kombinimi i të gjitha veprimeve teknike dhe administrative, që synojnë mirëmbajtjen ose rivendosjen e një pajisje (fikses së zjarri) në gjendje funksionimi.
11. **Pajisje për mirëmbajtje, Rimbushje dhe testimi i fikses së zjarrit:** Pajisjet e nevojshme të një shoqërie për kontrollin, mirëmbajtjen, rimbushjen dhe proven/testin hidraulik të fikses së zjarrit ?
12. **Personi kompetent:** Punonjes i shoqërisë së autorizuar, i cili ka trajnimin ose përvojën e nevojshme dhe aksesin në mjetet dhe pajisjet përkatëse dhe është në gjendje të kryejë procedurat periodike të mirëmbajtjes, rimbushjes të fikses së zjarrit dhe test/proven hidraulike të cilindrit.

Neni 4

Kërkesat teknike

1. Fikset e zjarrit, që importohen dhe hidhen në treg për herë të parë, duhet të plotësojnë kërkesat sipas standarteve/normave të miratuara të vendeve të Bashkimit Evropian, EN. Për të garantuar efikasitetin e duhur të fikseve të zjarrit si mjete shuarës, duhet që ato të jenë të ndertuar/prodhuara sipas standardeve të mëposhtme:
 - a) EN-3. “Fikse portative të zjarrit”
 - b) EN 1866 “Fikse me rrota”.
 - c) EN 615 “agjent pluhur për fikjen e zjarrit”
 - d) EN 1568 “agjent shkume për fikjen e zjarri”
2. Fikset e zjarrit duhet të kenë shenjat si me poshte ne perputhje me standartet perkatese:
 - a) duhet te kene shenjen e stampuar me relief në cilindër më poshtë:
 - i. Emrin ose markën e prodhuesit,
 - ii. Numrin serial,
 - iii. Vitin e prodhimit,
 - iv. Presionin e testimit (PT)
 - v. Presionin maksimal të lejuar (PS)
 - vi. Simbolin EN sipas llojit të fikseve
 - vii. Simbolin CE
 - b) Duhet te kene etiketen në gjuhën shqip dhe anglisht, me sa më poshtë:
 - i. Tipin e fikses sipas lëndës shuarëse
 - ii. Sasinë e lëndës shuarëse
 - iii. Klasa e zjarrit
 - iv. Udhëzimet për përdorim dhe mirëmbajtje
 - c) Duhet të kenë etiketën e kontrollit me datën e shitjes së pajisjes dhe datat për shërbimet e mirëmbajtjes
3. Fikset e zjarrit duhet të jenë të pajisura me skede teknike, deklarata origjine dhe certifikatë prodhimi sipas standarteve përkatëse.
4. Vlerësimi i konformitetit dhe certifikimi i fikseve të zjarrit kryhet nga një subjekt/organizëm i akredituar, i një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, i cili kryen sa më sipër, sipas standarteve në fuqi.
5. Sistemet stacionare manuale dhe automatike për shuarjen e zjarreve duhet të plotësojnë kërkesat sipas standarteve/normave të miraturara të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të shoqerohen me deklarate origjine, skede teknike të komponenteve dhe certifikata.
6. Personi fizik/Juridik i cili Importon, Tregton dhe Instalon fikset e zjarrit dhe Sistemet stacionare për shuarje zjarri duhet të jetë i jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të disponojë Liçencë kodi I.2.A, kategoria “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile”
7. Kontrollin mbi përmbushjen e kërkesave teknike si dhe disponibilitetin e mjeteve dhe pajisjeve, nga ana e personave fizikë dhe juridikë të cilët merren me Importin, Tregtimin, Instalimin dhe Mirëmbajtjen fikseve të zjarrit si dhe Sistemeve stacionare për shuarje e zbaton Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-se.
8. Kontrollin mbi përmbushjen e kërkesave teknike nga ana e personave fizikë dhe juridikë të cilët duhet t'i posedojnë dhe shfrytëzojnë këtë pajisje, e zbaton shërbimi vendor i MZSH-së, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore.

Neni 5

Përzgjedhja e aparateve të fikseve të zjarrit

1. Numri i nevojshëm, lloji dhe madhësia e aparateve për fikjen e zjarrit, përcaktohet në përputhje me klasën e klasifikimit të zjarrit i cili mund të ndodhë, sipërfaqen e sektorit të zjarrit dhe llogaritjen specifike të ngarkesës së zjarrit në sektorin e zjarrit.
2. Numri i fikseve të zjarrit në lidhje me ngarkesën specifike të zjarrit dhe sipërfaqen e sektorit të zjarrit përcaktohen në tabelën *e Shtojcës 1*, e cila është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi dhe ndahet në sektorë të zjarrit në mënyrë që në çdo kat të objektit të vendoset të paktën një aparat i fikses së zjarrit, përveç nëse me akte tjera ligjore nuk parashikohet ndryshe.
3. Aparatet për fikjen e zjarrit sipas pikës 2, i këtij neni janë:
 - a) Fikse zjarri me pluhur: 6 kg, 9 kg, 12 kg, 25 kg, 50 kg, 100 kg
 - b) Fikse zjarri me shkume: 6 Lt, 9 Lt, 12 Lt, 25 Lt, 50 Lt, 100 Lt
 - c) Fikse zjarri me CO₂: 2 kg, 5 kg, 10 kg, 20 kg, 25 kg, 30 kg, 45 kg
 - d) Fikse zjarri me HFC/FM200 /NOVEC1230 /FK-5-1-12
 - e) Per sistemet stacionare te shuarjes se zjarrit, cilinder me HFC/FM200, NOVEC, CO₂, gazra te floruara, gjenerator aerosoli etj
4. Përjashtimisht, për sektorët e zjarrit me sipërfaqe deri 20 m² me një ngarkesë të vogël ose të mesme specifike të ngarkesës së zjarrit, si aparate të vetme për fikje të zjarrit duhet të përdoren.
 - a) Fikse zjarri me pluhur 6 kg
 - b) Fikse zjarri me shkume 6 lt
 - c) Ne kushte te vecanta fikse zjarri me CO₂ 2 kg
5. Në sektorët e zjarrit me ngarkesë të mesme ose te lartë specifike të zjarri në sipërfaqe prej çdo 200m², duhet te vendoset nga një fikse zjarri me rrota, pluhur/shkume 25-50 kg/lt.
6. Numri dhe kapaciteti shuares i fikseve portative duhet te jete ne perputhje me:
 - numrin e kateve (minimalisht nje fikse ne kat).
 - siperfaqes së katit dhe ndarjeve brenda katit (sipas shtojces 1)
 - rreziqeve specifike ndaj zjarrit (klasave të zjarrit)
 - distancës që duhet të përshkrojë një person për ta përdorur një fikse.
7. Kapacitetit/aftësitë shuarëse të aparateve për shuarjen e zjarrit të ndare në klasa është sipas *Shtojces nr.2 (bashkëlidhur)*.
8. Kompletimi me aparatet e fikjes së zjarrit sipas kategorizimit të mjediseve nga rreziku ndaj zjarrit është sipas *shtojces nr.3 (bashkëlidhur)*.

Neni 6

Mirëmbajtja e fikseve të zjarrit / sistemeve stacionare shuarëse

1. Mirëmbajtja dhe funksionimi i duhur i aparateve për fikseve të zjarrit bëhet përmes

kontrollit të rregullt, mirëmbajtjes periodike, rimbushjes periodike dhe proves/testit hidraulik të cilindrit.

2. Fikset e zjarrit dhe sistemet stacionare manuale dhe automatike për shuarjen e zjarreve, që qarkullojnë në treg duhet t'i nënshtrohen kontrollit të rregullt, mirëmbajtjes periodike, rimbushjes periodike dhe test/provës hidraulike të cilindrit, për të garantuar funksionalitetin normal të tyre.
3. Cdo fikse zjarri e cila kalon në procesin e mirëmbajtjes duhet të pajiset me instruktimin e përdorimit në gjuhën shqipe, sëbashku me logon e subjektit, me qafore plastike si dhe me etiketën e mirëmbajtjes.
4. Të gjitha proceset e mirëmbajtjes sipas muajit dhe vitit do të jenë të pasqyruara në etiketën e mirëmbajtjes.
5. Është detyrë e personit kompetent që të këshillojë poseduesin e fikseve të zjarrit se kur, sipas mendimit të tij, duhet të nxirret jashtë funksionimit një fikse zjarri.
6. Kohëzgjatja e funksionimit të një fikse zjarri ndryshon ndjeshëm për shkak të faktorëve të ndryshëm si ndikimi mjedisor, trajtimi i ashpër, etj.
7. Kohëzgjatja e funksionimit të një fikse zjarri nuk duhet të kalojë 20 vite nga data e prodhimit.
8. Personi fizik/juridik i cili kryen shërbimet e mirëmbajtjes periodike, rimbushjes periodike si dhe test/provën hidraulike të cilindrit, duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të disponojë Liçencë kodit I.2.A, kategoria "Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile"
9. Personi fizik/juridik i cili posedon dhe shfrytëzon këto pajisje duhet të zbatojë afatet për shërbimin e mirëmbajtjes të përcaktuar në këtë udhëzim. Nëse konstatohen shkelje, ndaj tyre merren masa administrative sipas ligjit 152/2015.

Neni 7

Kontrolli i rregullt

1. Kontrolli i rregullt i fikseve të zjarrit bëhet të paktën 1 herë në muaj nga subjekti që e posedon, i cili kryen kontrole të rregullta të të gjithë fikësve të zjarrit për të siguruar që:
 - a. gjendet në vendin e caktuar,
 - b. është i dukshëm dhe i aksesueshem për përdorim,
 - c. ka manometrin e presionit brenda fushes së lejuar,
 - d. ka fijen plastike të pademtuar,
 - e. ka siguresen metalike të valvules së aparatit përfikjetëzjarrit
 - f. ka udhëzime mbi përdorimin e fikses
 - g. nuk ka shenja të dukshme dëmtimi,.
2. Të gjitha veprimet e mësipërme, duhet të mbahen shënim nga ana e subjektit që posedon fikset dhe sistemet stacionare të shuarjes së zjarrit.
3. Në rast konstatimi të demtimeve, fikset e zjarrit/sistemet e shuarjes së zjarrit duhet të kalojnë në mirëmbajtje periodike/rimbushje periodike/prove hidraulike.
4. Subjekti që e posedon fikset e zjarrit dhe/ose sistemet stacionare të shuarjes së zjarrit

duhet të sigurojë që ato të inspektohen dhe mirëmbahen vetëm nga subjekte të licencuara në këtë fushë.

Neni 8

Mirëmbajtja periodike

1. Gjatë mirëmbajtjes periodike verifikohet konformiteti dhe funksionaliteti i fikseve të zjarrit dhe/ose sistemeve të shuarjes së zjarrit si dhe pjesëve përbërëse të tyre
2. Gjatë mirëmbajtjes periodike nëse do të jetë e nevojshme bëhet zëvendësimi i pjesëve të amortizuara dhe të dëmtuara me pjesë rezervë të aprovuara nga prodhuesi. Nëse nuk zëvendësohen pjesët e dëmtuara, fiksja del jashtë përdorimit.
3. Mirëmbajtja periodike kryhet të paktën një herë në 12 muaj, ose pas çdo defekti të vërejtur në fikse zjarri/sisteme për shuarje zjarri.
4. Në çdo mirëmbajtje periodike të fikseve të zjarrit me manometër tregues të presionit, duhet të vendoset një qafore plastike, me ngjyrë të vecante nga viti në vit. Qaforja/unaza plastike vendoset ndërmjet qafes së cilindrit dhe valvulës së fikses dhe ka të stampuar muajin dhe vitin e kryerjes së shërbimit.
5. Etiketa e mirëmbajtjes duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
 - a) Kohën e kryerjes së mirëmbajtjes periodike (muajin dhe vitin)
 - b) Logon e personit fizik/juridik që e trajton
6. Lloji dhe Ngjyra e qafores plastike, për çdo vit, si dhe etiketa e mirëmbajtjes miratohet nga Drejtoria e MZSH dhe duhet të jetë e unifikuar për të gjithë personat fizik/juridik.
7. Mirëmbajtja periodike duhet të kryhet vetëm në vitet 1,2,3,5,6,7,9,10,11,13,14, 15,17,18,19.
8. Intervalet janë të vlefshme nga data e instalimit të fikses së zjarrit dhe jo më vonë se një vit nga viti i prodhimit të shënuar në trupin e fikses të zjarrit.
9. Mirëmbajtja e mëtejshme në vitin 4 dhe të 12 përfshin rimbushjen periodike (zëvendësimin total të lëndës shuarese).
10. Mirëmbajtja e mëtejshme në vitet 8 dhe 16 përfshijnë testin/proven hidraulike të cilindrit si dhe rimbushjen (zëvendësimin total të lëndës shuarese).
11. Çdo fikse zjarri ose pjesët e saj do të konsiderohen jo të sigurt për përdorim, nëse sipas mendimit të personit kompetent:
 - a) gjendja e saj fizike konsiderohet jo normale.
 - b) do të ishte i rrezikshëm për t'u përdorur.
 - c) gjendja e saj fizike mund të pengojë funksionimin normal.
 - d) në rast se ka humbje të përmbajtjes ose presion më të madh se ai i rekomanduar nga prodhuesi.
12. Personi kompetent kontrollon nëse fiksja e zjarrit përputhet me rregullat e percaktuara në këtë udhëzim.
13. Personat që i posedojnë pajisjet e mbrojtjes nga zjarri duhet të marrin parasysh se mirëmbajtja, si dhe procedurat e rimbushjes dhe test/prova të cilindrit, mund të zvogëlojnë përkohësisht efektivitetin e masave parandaluese të mbrojtjes nga zjarri.
14. Pas kryerjes së procesit të mirëmbajtjes periodike, çdo fikse zjarri/cilindër kolaudohet

dhe garanton funksionalitetin e duhur.

Neni 9

Rimbushja periodike

1. Rimbushja periodike është një shërbim i nevojshëm për të garantuar efikasitetin e lëndës shuarësi dhe funksionalitetin e fikses së zjarrit
2. Rimbushja periodike kryhet cdo 4 vjet nga data e prodhimit të shënuar në trupin e fikses së zjarrit si dhe pas çdo aktivizimi/perdorimi.
3. Para rimbushjes, fikset e zjarrit do të zbrazen plotësisht dhe agjenti shuares ekzistues do të hiqet/hidhet dhe do të konsiderohet i papërdorshëm.
4. Fikset e zjarrit duhet të rimbushen sipas udhëzimeve të dhëna nga prodhuesi.
5. Lenda shuarese duhet të jete konform standarteve/normave të miratuara, EN 615 “agjent pluhur për fikjen e zjarrit”; EN 1568 “agjent shkume për fikjen e zjarri”
6. Lenda shuarese duhet të shoqerohet me certifikate analize nga laboratore në vende të Bashkimit Evropian, skede teknike dhe deklarate origjine në zbatim të nenit 44 të ligjit 152/2015.
7. Në fikset e zjarrit që janë rimbushur, për çfarëdo arsye, do të vendoset qaforja/unaza plastike si dhe do të shënohet data e rimbushjes.
8. Të dhënat e inspektimit dhe mirëmbajtjes duhet të regjistrohen në një etiketë e cila nuk duhet të mbulojë shenjat e prodhuesit.
9. Në etiketë duhet të jepen të dhënat e mëposhtme:
 - a) e kontrolluar nga shoqëria e autorizuar, emri dhe adresa e shoqërisë
 - b) data e kontrollit-mirëmbajtjes ose e rimbushjes (viti dhe muaji).
 - c) data (viti dhe muaji) në të cilin do të kryhet procedura e radhës.
 - d) Intervalet e Kontrollit Periodik – Mirëmbajtjes

Neni 10

Prova hidraulike e cilindrit

1. Prova Hidraulike e cilindrit është një shërbim i rëndësishëm për të garantuar funksionalitetin e fikses së zjarrit/sistemeve stacionare të shuarjes.
2. Prova hidraulike kryhet cdo 8 vjet nga data e prodhimit të shënuar në trupin e fikses të zjarrit dhe cdo 10 vjet nga data e prodhimit të shënuar në trupin e cilindrave të sistemeve stacionare.
3. Prova hidraulike kryhet me pajisje dhe mjete të posacme, me ane të cilave testohet fortësia mekanike e cilindrit, presioni maksimal i mbartur, rregullsia e valvulës siguroese dhembylljahermetikeetij.
4. Pasi kalohet me sukses procesi i proves, fikset e zjarrit/sistemet stacionare, mbushen me lëndet shuarese dhe kolaudohen duke garantuar funksionalitetin e duhur të tyre

Neni 11

Mjetet dhe pajisjet per kryerjen e 2it te Mirembajtjes

1. Ambjentet për kryerjen e mirembajtjes periodike, rimbushjes periodike si dhe provës/test hidraulik të cilindrit, të përcaktuara ne këtë udhëzim, duhet të jenë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si vend ushtrimi aktiviteti i personit fizik/juridik që kryen shërbimet e mirëmbajtjes.
2. Hapësira e nevojshme për kryerjen e shërbimit duhet të jete minimalisht 100 m2,
3. Pajisjet minimale të nevojshme të kërkuara për funksionimin e shoqërisë së autorizuar janë:
 - a) Pompa mbushëse per pluhur, CO2 etj.
 - b) Morse pneumatike
 - c) Kompresor ajri
 - d) Pompë hidraulike me pajisje për tharjen e cilindrave dhe të gjithë aksesorët e nevojshëm me presionin e kërkuar.
 - e) Pajisje për mbushjen e gazit shtytës
 - f) Peshore elektronike me lexim deri në 200 kg dhe sensitivitet 20 gr.
 - g) Pompe për testim hidraulik të cilindrit/testim hidraulik te tubave zjarrfikes;
 - h) Pjese kembimi per fikset e zjarrit, tub sifoni, tub shkarkimi, valvul, manometer, tela siguresse etj.
 - i) Bango pune
 - j) Set veglash-celesash
4. Personi fizik/juridik i cili kryen shërbimet e mirëmbajtjes periodike, rimbushjes periodike si dhe test/provën hidraulike të cilindrit duhet të ketë punonjës të trajnuar nga kompani prodhuese për kryerjen e Mirëmbajtjes së fikseve të zjarrit dhe /ose Sistemeve stacionare të shuarjes së zjarrit

Neni 12

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen subjektet që tregetojne aparatet e fikjes së zjarrit, për kontrollin e subjekteve në zbatim të këtij udhëzimi ngarkohet sherbimi vendor i MZSH-se.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi menjehere.

MINISTRI

BLEDAR ÇUÇI

Sipërfaqja e sektorit të zjarrit në m ² deri në	Ngarkesa specifike e zjarrit		
	E ulët deri 1 Gj/ m ²	E mesme deri 2 Gj/ m ²	E lartë deri 3 Gj/ m ²
20	1*	1*	1
50	2	2	2
100	2	2	3
150	2	3	3
200	3	3	4
300	3	3	5
400	3	4	6
500	3	4	7
750	4	6	9
1000	5	7	12
2000	6	9	17
3000	7	12	22
4000	10	17	32
5000	12	22	42
6000	15	27	52
7000	17	32	62
8000	20	37	72
9000	22	42	82
10000	27	52	101

Shtojca 1-Numri aparateve për fikje të zjarrit në bazë të ngarkesës specifike të zjarrit dhe sipërfaqes së sektorit të zjarrit: EN 3-7

NJSH	Kapaciteti / aftësia shuarëse e aparateve për shuarjen e zjarrit sipas EN 3-7		
	KLASA A (materialet e ngurta)	KLASA B (materialet e lëngëta)	KLASA F (vajrat e gatimit)
1	5A	21B	5F
2	8A	34B	
3		55B	25F
4	13A	70B	
5		89B	40F
6	21A	113B	
9	27A	144B	75F
10	34A		
12	43A	183B	
15	55A	233B	

Shtojca 2. Shembuj të kapacitetit / aftësitë shuarëse të aparateve për shuarjen e zjarrit sipas;EN 3-7.